



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

I-GJA.nr.1/2023-4
23 Janar 2023

RAPORTI I PUNËS – 2022
PËR: Këshillin Gjyqësor të Kosovës

REPUBLIKA E KOSOVËS
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN
KRYETARJA
SHPRESA EMRA

JANAR 2023

PËRMBAJTJA

PJESA E I-rë

Përmbledhje ekzekutive

I. Informata të Përgjithshme për Gjykatën Themelore në Prizren

- 1.1 Raporti i Përgjithshëm dhe krahasimi i tremujorëve për performancën e Gjykatës
- 1.2 Gjykata Themelore – Dega në Suharekë
- 1.3 Gjykata Themelore – Dega në Dragash
- 1.4 Raporti për ndarjen e lëndëve për Gjyqtarë – Ngarkesa e gjyqtarëve me lëndë 2022
- 1.5. Raporti mbi ecurinë e lëvizje së Gjyqtarëve gjatë vitit 2022
- 1.6 Raporti mbi ecurinë e stafi administrativ 2022
- 1.7 Raporti mbi lëndët për procedurat SMIL - SQEP

PJESA E II-të

2. Aktivitet e Gjykatës Themelore në Prizren

- 2.1 Ri funksionalizimi i objektit të Gjykatës për Divizionin Civil
- 2.2 Raporti mbi regjistrimin dhe asgjësimin e lëndëve të Kundërvajtjes
- 2.3 Qasja në Gjykatë – Takimet me Qytetarët
- 2.4 Raporti mbi publikimin e vendimeve Gjyqësore
- 2.5 Raporti mbi rastet disiplinore
- 2.6 Raporti mbi trajtimin e rasteve me interes publik

PJESA E III-të

3. Përfundimi – Të arriturat për vitin 2022



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THËMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU - BASIC COURT OF PRIZREN

Bazuar në nenin 14 paragrafi 2 pika 2.4 të Ligjit për Gjykata, Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prizren, paraqet raportin e rregullt të punës për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2022.

PJESA E I-rë

Përmbledhje ekzekutive

Raporti i Punës për vitin 2021 paraqet dokumentin bazë për aktivitetin e Gjykatës Themelore në Prizren, dhe degët e saj Suharekë dhe Dragash.

Ky raport prezanton aktivitetet e Gjykatës, nga data 1 janar deri më 31 dhjetor të vitit 2022, në të cilin përfshihet veprimtaria, të arriturat dhe sfidat me të cilat është përballur Gjykata, gjatë kësaj periudhe.

Në pjesën fillestare, raporti paraqet përfomancën e Gjykatës Themelore në Prizren dhe degëve Suharekë dhe Dragash, dhe krahasimin e përfomancës në periudha të ndryshme kohore (tremujori i I-rë, dhe kështu me radhë). Gjithashtu në këtë pjesë në raport paraqiten informata për lëvizjen e Gjyqtarëve, (avancime, pensionime), gjendjen aktuale me Gjyqtarë dhe nevojat e Gjykatës Themelore në Prizren dhe degëve në Suharekë dhe Dragash. Gjithashtu në këtë pjesë përmban edhe gjendjen me stafin administrativ, nevoja të Gjykatës për plotësimin e vendeve të punës dhe mundësinë e stafit administrativ.

Në vijimësi raporti përmban të dhënat për aktivitetet e Gjykatës dhe të Kryetares së Gjykatës që nga fillimi i mandatit të saj në Maj të vitit 2022. Pastaj qasja e palëve në Gjykatës, transparenca dhe komunikimi me publikun, trajtimi i rasteve disiplinore në bazë të ankesave të qytetarëve, dhe trajtim i rasteve me interes për publikun.

Në fund të raportit janë paraqitur të arriturat për vitin 2022, dhe sfidat që parashihen për vitin 2023 që ndërlidhen me objektin e Gjykatës dhe stafin e saj.

1. Informata të Përgjithshme për Gjykatën Themelore në Prizren

Më lejoni që menjëherë në fillim të ju informoi se Gjykata Themelore në Prizren vitin 2022 në dy pozitat menagjuese atë të Administratorit dhe Kryetarit të Gjykatës e ka filluar me Ushtrues Detyre, përderisa unë në muajin MAJ të 2022, kam marrë detyrën e Kryetares, pozita e Administratorit të Gjykatës mbetet ende me ushtrues detyre. Kjo në vete përmban një sfidë, sepse pozitat kyçe për menaxhimin e Gjykatës kanë qenë të paplotësuara, respektivisht ajo e Administratorit mbetet ende njëjtë.

Viti 2022 ka pasur sfidat e saj, duke filluar nga lëvizja e Gjyqtarëve – pensionime dhe avancime në Gjykatën Themelore por edhe në degën në Suharekë, ndërsa sfidë që vazhdon të jetë edhe sot është numri i të punësuarve në Administratë të cilët janë pensionuar dhe mos plotësimi i këtyre pozitave me kohë.

Pos sfidave të përditshme, viti 2022 ka shënuar edhe sukseset për Gjykatën Themelore në Prizren, duke filluar nga riorganizimi i stafit, rekrutim i Bashkëpunëtorëve profesional, riorganizimi, rekrutimi i zyrtarëve administrativ dhe ri funksionalizimi i objektit përcjellës ku tashmë funksionon Divizioni Civil, rritja efikasiteti në tremujorin e 3-të dhe të 4-të, shpërndarja e barabartë e punës, përmirësimi i gjendjes në Arkiva dhe aktivitet të tjera, që kanë rezultuar drejtpërdrejt në efikasitet të punës dhe në përmasimin e besueshmërisë tek publiku.

REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

1.1 Raporti i përgjithshëm dhe statistikor i Gjykatës për vitin 2022

Në bazë të të dhënave të përpunuara nga sistemi SMIL, Gjykata Themelore në Prizren, ka treguar një efikasitet të lartë, kryesisht rreth 80% të zgjidhjes së lëndëve, që krijon një hapësirë që gjatë vitit 2023, ky efikasitet të tejkaloj normën 100%.

Ndarë në Departamente si në vijim:

Departamenti i Krimeve të Rënda: në fillim të vitit 2022 ka trashëguar 161 raste, ndërsa gjatë vitit 2022 janë pranuar në punë 266 raste të reja. Gjatë vitit 2022 janë zgjidhur 215 raste apo me efikasitet prej 81%.

Ky departament ka një efikasitet të mirë, dhe trajtimi i rasteve në aspektin kohor në këtë departament (kur nuk ka pengesa ligjore) është brenda një afati shumë të mirë, pasi që nuk ka vonesa në caktimin e shqyrtimeve fillestare dhe shqyrtimeve gjyqësore.

Departamenti për të Mitur: në fillim të vitit 2022 ka trashëguar 186 raste, ndërsa gjatë vitit 2022 janë pranuar në punë 111 raste të reja. Gjatë vitit 2022 janë zgjidhur 124 raste apo me efikasitet prej 112%.

Angazhimi i dy (2) gjyqtareve në këtë departament ka treguar rritje të efikasiteti dhe edhe gjatë vitit 2023 nuk do të ketë ndryshime sa i përket numrit të Gjyqtareve në këtë departament.

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal: në fillim të vitit 2022 ka trashëguar 2,392 raste, gjatë vitit 2022 janë pranuar në punë 1445 raste të reja. Në vitin 2022 janë zgjidhur 1,327 raste apo me efikasitet prej 92%.

Ky departament në vazhdimësi ka një efikasitet të ngjashëm, ndërsa mbetet që gjatë vitit 2023 të ketë angazhim më të madh në zgjidhjen e rasteve me ndërmjetësim.

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil:

Në lëmine KONTESTIMORE në fillim të vitit 2022 janë trashëguar 5529 lëndë, gjatë vitit 2022 janë pranuar 4280 lëndë, pra gjithsej në punë 9.809 lëndë. Kjo është sfidë jashtëzakonisht e madhe menaxhimi i një numri kaq të madh të lëndëve, mirëpo në këtë drejtim konsiderojmë se në gjashtë mujorin e II-të të vitit 2022 Gjykata ka arritur me sukses të menaxhojë këtë Divizion.

Gjatë vitit 2022 janë zgjidhur 2207 lëndë të natyrës kontestimore, apo me një normë efikasiteti prej 52%. Kjo normë efikasiteti përkundër se mund të duket jo shumë e lartë, nuk paraqet realitetin sepse numri i lëndëve të ardhura është jashtëzakonisht i lartë.

Sikurse në të gjitha Gjykatat në këtë Divizion mbetet sfiduese numri i lartë lëndëve në ardhje, mirëpo Gjykata Themelore në Prizren në këtë drejtim ka pasur një organizim të mirë dhe

efikasitet të kënaqshëm falë edhe rekrutimit të bashkëpunëtorëve profesional dhe rritjes së numrit të Gjyqtarëve në këtë divizion në tetë (8) Gjyqtarë sa ka qenë në disa periodha me vetëm katër (4) gjyqtarë.

Në lëmine **JO KONTESTIMORE**, në fillim të vitit 2022 ka trashëguar 829 lëndë, gjatë vitit 2022 janë pranuar në punë 262 raste të reja. Në vitin 2022 janë zgjidhur 200 raste apo me efikasitet prej 76%, ndërsa kanë mbetur 891 lëndë aktive.

Në lëmine **PËRMBARIMORE**, në fillim të vitit 2022 ka trashëguar 2,231 raste, gjatë vitit 2022 janë pranuar në punë 2,416 raste të reja. Në vitin 2022 janë zgjidhur 2,124 raste apo me efikasitet prej 88%, ndërsa kanë mbetur 2,523 lëndë aktive.

Divizioni i **KUNDËRVAJTJES**: në fillim të vitit 2022 ka trashëguar 1,683 raste, gjatë vitit 2022 janë pranuar në punë 2,560 raste të reja. Në vitin 2022 janë zgjidhur 2,141 raste apo me efikasitet prej 84%, ndërsa kanë mbetur 2,102 lëndë aktive. Shohim që gjatë viti 2022 ka pasur një rritje të rasteve të reja të pranuar në krahasim me vitet e kaluara. “

Në lëmi të EKZEKUTIMEVE Gjatë vitit 2022, Gjykata Themelore në Prizren ka një efikasitet të lartë të ekzekutimit të sanksioneve penale, e që në vitin 2023, synojmë ta përmirësojmë edhe më shumë këtë efikasitet.

Dënime me Gjobë: Gjatë vitit 2022 janë pranuar 585 lëndë, ndërsa janë zgjidhur 600 lëndë, apo me një efikasitet prej 102%.

Dënime me Burgim – Gjatë vitit 2022, janë pranuar në punë 116 lëndë, kurse janë zgjidhur 132 lëndë, pra një efikasitet prej 113%.

1.2 Gjykata Themelore – Dega në Suharekë

Gjykata Themelore – DEGA në Suharekë, aktualisht ka katër (4) Gjyqtarë, të ndarë nga dy (2) Gjyqtarë për Divizionin Penal dhe Civil, kurse lëndët nga Divizioni i Kundërvajtjes gjykohen nga Gjyqtarë të Gjykatës Themelore në Prizren.

Gjykata Themelore – Dega në Suharekë, në bazë të të dhënave të përpunuara nga sistemi SMIL, ka treguar një efikasitet të lartë të zgjidhjes së lëndëve në të dy (2) Divizionet, përkundër lëvizjeve të Gjyqtarëve gatë vitit 2022 në këtë Gjykatës.

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal: në fillim të vitit 2022 ka trashëguar 581 raste, gjatë vitit 2022 janë pranuar në punë 482 raste të reja. Në vitin 2022 janë zgjidhur 566 raste apo me efikasitet prej 117%.

Ky departament në vazhdimësi ka një efikasitet të lartë të zgjidhjes së rasteve, kjo tregon një angazhim të mirë të Gjyqtarëve, qoftë në caktimin e seancave apo në përpilimin e vendimeve brenda afateve ligjore.

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil:

Në lëmine **KONTESTIMORE** në fillim të vitit 2022 janë trashëguar 2,202 lëndë, gjatë vitit 2022 janë pranuar 1,351 lëndë, pra gjithsej në punë 3,553 lëndë. Kjo është sfidë jashtëzakonisht e madhe menaxhimi i një numri kaq të madh të lëndëve, mirëpo Gjyqtari mbikëqyrës ka arritur me sukses të menaxhojë këtë Divizion, pasi që i njëjti edhe Gjykon dhe ndarja e barabartë e lëndëve ka qenë një hap i suksesshëm për trajtimin e rasteve.

Gjatë vitit 2022 janë zgjidhur 918 lëndë të natyrës KONTESTIMORE, apo me një normë efikasiteti prej 68%. Kjo tregon një trajtim të mirë të lëndëve, përkundër faktit se janë vetëm dy (2) Gjyqtarë të lëmisë Civile dhe numri të mardh të rasteve të reja të ardhur anë punë.

Në lëmine **JO KONTESTIMORE**, gjatë vitit 2020 ka një efikasitet prej 99% të zgjidhjes së lëndëve. Në fund të vitit 2022 kanë mbetur 68 lëndë të pazgjidhura.

Në lëmine **PËRMBARIMORE**, gjatë vitit 2022 ka pasur një efikasitet prej 114% të zgjidhjes së lëndëve. Gjatë vitit 2022 kanë qenë 2,229 lëndë në punë. Në fund të vitit 2022 kanë mbetur 1,010 lëndë të pazgjidhura.

Divizioni i **KUNDËRVAJTJES**: gjatë vitit 2022 ka treguar një efikasitet prej 74%. Në fund të vitit 2022 kanë mbetur 2,141 lëndë të pazgjidhura. Në këtë Divizion ka një rënie për shkak të pensionimit të Gjyqtarëve dhe është dashur të mbulohet me Gjyqtarë nga Gjykata Themelore e Prizrenit.

1.3 Gjykata Themelore – Dega në DRAGASH

Gjykata Themelore – DEGA në Dragash, ka dy (2) Gjyqtarë të angazhuar. Mbikqyrësi i cili trajton lëndë Penale edhe në Gjykatën Themelore në Prizren, dhe një (1) Gjyqtare e cila trajton lëndë të të gjitha natyrave.

Gjykata Themelore – Dega në Dragash, në bazë të të dhënave të përpunuara nga sistemi SMIL, ka një efikasitet të ngjashëm në vazhdimësi, mirëpo ky rezultat mund të ketë përmirësim me një angazhim dhe përkushtim gjatë vitit 2023.

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal: në fillim të vitit 2022 ka trashëguar 212 raste, gjatë vitit 2022 janë pranuar në punë 145 raste të reja. Në vitin 2022 janë zgjidhur 101 raste apo me efikasitet prej 70%.

Ky departament në vazhdimësi ka një efikasitet të ngjashëm, mirëpo në fund të vitit 2022 ka më shumë lëndë të trashëguara se në vitin paraprak, andaj gjatë 2023 do të ketë vëmendje që numri i lëndëve penale në pritje të jetë edhe më i ulët.

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil:

Në lëmine **KONTESTIMORE** në fillim të vitit 2022 janë trashëguar 697 lëndë, gjatë vitit 2022 janë pranuar 594 lëndë, pra gjithsej në punë 1,273 lëndë. Duke marrë parasysh që lëndët e kësaj natyre i trajton vetëm një Gjyqtare, kjo përbën sfidë në vete menaxhimi dhe trajtimi i të gjitha këtyre rasteve, andaj do të shikohet mundësia e riorganizimit gjatë vitit 2023, me qëllim të trajtimit të këtyre rasteve.

Gjatë vitit 2022 janë zgjidhur 229 lëndë të natyrës KONTESTIMORE, apo me një normë efikasiteti prej 39%.

Në lëmine **JO KONTESTIMORE**, gjatë vitit 2020 ka një efikasitet prej 52% të zgjidhjes së lëndëve. Në fund të vitit 2022 kanë mbetur 82 lëndë të pazgjidhura.

Në lëmine **PËRMBARIMORE**, gjatë vitit 2022 ka pasur një efikasitet prej 39% të zgjidhjes së lëndëve. Gjatë vitit 2022 kanë qenë 802 lëndë në punë. Në fund të vitit 2022 kanë mbetur 613 lëndë të pazgjidhura.

Divizioni i **KUNDËRVAJTJES**: gjatë vitit 2022 ka treguar një efikasitet prej 138%. Në fund të vitit 2022 kanë mbetur 83 lëndë të pazgjidhura.

1.4 Raporti për ndarjen e lëndëve për Gjyqtarë – Ngarkesa e gjyqtarëve me lëndë 2022

Duke pasur parasysh se ka pasur lëvizja të gjyqtarëve gjatë tërë vitit për shkak të pensionimit, avancimeve dhe formave tjera të lëvizjes është paraqitur nevoja për ndarje dhe rërcaktim të lëndëve nga një gjyqtar tek gjyqtarët tjerë. Kjo është bërë në mënyrë manuale-me short dhe në mënyrë elektronike me sistem SMIL. Që nga muaji maj ka pasur lëvizje të 7 gjyqtarëve dhe të gjitha lëndët janë ndarë në mënyrë proporcionale dhe të barabartë tek gjyqtarët të caktuar për pranim të këtyre lëndëve. Gjithashtu 4 gjyqtarë të ri të lëmisë civile me 01.04.2022 kanë filluar pranimin lëndë të reja dhe në atë periudhë gjyqtarët të cilët kanë qenë në punë nuk kanë pranuar lëndë të reja në mënyrë që të barazohen me lëndët e pranuar nga gjyqtarët e ri. Me këtë sistem është arritur që të gjithë gjyqtarët të kenë numër të përafërt të lëndëve në punë.

Në bazë të të dhënave të përpunuara nga SMIL, Gjyqtarët janë të ngarkuar me lëndës si në vijim (*Gjyqtari me më së paku lëndë, dhe Gjyqtari me më së shumti lëndë*).

Gjykata Themelore Prizren

Departamenti për Krime të Rënda – gjyqtarët kanë nga 28 lëndë deri në 40 më së shumti. Janë edhe 21 lëndë të një Gjyqtari i cili pensionohet në muajin Shkurt, dhe këto lëndë do të rërcaktohen pasi i njëjti të përfundojë mandatin.

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal – gjyqtarët kanë nga 230 lëndë deri në 400 (përrjashtimisht një (1) Gjyqtar që ka 680 lëndë.

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil – gjyqtarët kanë nga 780 lëndë (Gjyqtari me më së paku lëndë aktive), deri në 1.050 lëndë për Gjyqtarë (Gjyqtari me më së shumti lëndë aktive).

Gjykata Themelore – Dega në Suharekë

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal – Një (1) Gjyqtar 160 lëndë, Një (1) Gjyqtarë 220 lëndë aktive.

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil – Një (1) Gjyqtar ka 1,328 lëndë aktive, Një (1) Gjyqtar ka 1,226 lëndë aktive.

Në bazë të të hënave të përpunuara nga SMIL, për moshën e numrit të lëndëve në pritje, pritje në Gjykatën Themelore në Prizren dhe degët Suharekë & Dragash, është si në vijim:

Gjykata Themelore Prizren

Departamenti për Krime të Rënda – **Nga 212 lëndë në pritje**, janë 140 lëndë deri në 12 muaj, 25 lëndë 12 deri në 24 muaj të vjetra, ndërsa **47 lëndë më të vjetra se dy vite**.

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal – Nga 2,503 lëndë në pritje, 1,101 lëndë janë të vjetra deri në 12 muaj. 540 lëndë nga 12 deri në 24 muaj. Kurse 862 lëndë më të vjetra se 24 muaj.

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil – **Nga 7,600 lëndë Kontestimore**, 3,788 janë lëndë deri në 12 muaj të vjetra – pra afër 50%. 1,680 lëndë janë nda 12 deri në 24 muaj të vjetra, kurse **më të vjetra se 24 muaj janë gjithsej 2,131 lëndë**.

Gjykata Themelore – Dega në Suharekë

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal – **Nga 490 lëndë në pritje**, 279 janë lëndë të vjetra deri në 12 muaj apo mbi 50%. Ndërsa pjesa tjetër prej **211 lëndë janë të vjetra më shumë se 12 muaj**.

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil – **Nga 2633 lëndë Kontestimore**, 1,227 janë lëndë të vjetra deri në 12 muaj. Kurse pjesa tjetër prej **1,406 lëndë janë më të vjetra se 12 muaj**.

Gjykata Themelore – Dega në Dragash

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal – **Nga 256 lëndë në pritje**, rreth 60 % e lëndëve janë të vjetra deri në 12 muaj, kurse pjesa tjetër më të vjetra se 12 muaj.

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil – **Nga 1,044 lëndë Kontestimore**, rreth 65% janë të vjetra deri në 12 muaj, kurse pjesa tjetër më të vjetra se 12 muaj.

1.5 Raporti mbi ecurinë e lëvizjes së Gjyqtarëve gjatë vitit 2022

Gjykata Themelore në Prizren së bashku me degët, vitin 2023 e fillon me 33 gjyqtarë dhe Kryetarja. Gjithashtu tre (3) Gjyqtarë janë në fazën e trajnimit fillestar – dy (2) në Prizren, dhe një (1) në Suharekë, të cilët gjatë vitit 2023 do ti bashkëngjiten Gjykatës dhe do të ndahen në Departamente sipas nevojës.

Gjatë vitit 2022 ka pasur shumë lëvizje të Gjyqtarë në Gjykatën Themelore në Prizren, dhe në degën në Suharekë, përfshirë avancimin e Gjyqtarëve, angazhimet e tyre në KGJK dhe pensionimin e Gjyqtarëve.

Këto lëvizje për Gjykatën kanë krijuar sfidë dhe ngecje në trajtimin e lëndëve, pasi që me pensionimin apo avancime të Gjyqtarëve është dashur ricaktimi i lëndëve që kërkon kohë, si dhe trajtimi i këtyre rasteve në vazhdimësi nga Gjyqtarët e ri është sfidë në vete.

Në fillim të vitit 2022 dy (2) Gjyqtarë nga Gjykata Themelore në Prizren janë angazhuar me kohë të plotë në KGJK, dhe lëndët e tyre është dashur të ricaktohen dhe të ndahen në mënyrë të barabartë tek Gjyqtarë të tjerë.

Në tremujorin e II-të, kanë filluar angazhimin të plotë pesë (5) Gjyqtarë, katër (4) të caktuar në Divizionin Civil, çka ka treguar rezultat të menjëhershëm pasi që në periudhat e mëvonshme ky Divizion ka një efikasitet në rritje. Kurse një(1) gjyqtar është angazhuar në Divizionin Penal

Gjithashtu nga Gjykata Themelore në Prizren janë avancuar dy (2) Gjyqtarë, një (1) nga Departamenti i Krimeve të Rënda, dhe një (1) nga Divizioni Civil. Gjithashtu me zgjedhjen time si Kryetare e Gjykatës, është dashur ricaktimi i lëndëve me t cilat kam qenë e ngarkuar.

Gjykata Themelore – Dega në Suharekë, gjatë vitit 2022 janë pensionuar tre (3) Gjyqtarë, që ka rezultuar drejtpërdrejt me ngarkesë tek Gjyqtarët e tjerë, dhe kjo Gjykatë ka nevojë të plotësohet me Gjyqtarë në mënyrë që të zëvendësohen Gjyqtarët që janë pensionuar me qëllim të mbarëvajtjes së punës dhe efikasitet.

Në fillim të vitit 2023, nga Gjykata Themelore në Prizren pensionohet edhe një (1) Gjyqtar nga Departamenti i Krimeve të Rënda.

Këto lëvizje paraqesin sfidë dhe ngarkesë për Gjykatën pasi që në vazhdimësi ka lëvizje të lëndëve që krijojnë vonesë në trajtimin e tyre, mirëpo Gjyqtarët që kanë marrë këto lëndë janë udhëzuar që me kujdes ti trajtojnë ato që janë me prioritet sipas Strategjisë për Efikasitet dhe Prioritet.

1.6 Raporti mbi ecurinë e stafit administrativ 2022

Sikurse lëvizje të gjyqtarëve, në Gjykatën Themelore në Prizren në vitin 2022 ka pasur mjaft lëvizje edhe të stafit administrativ, të cilat po krijojnë vështirësi në mbarëvajtjen e punës, sepse pozitat e liruar nuk janë zëvendësuar, por na është dashur në forma alternative të gjejmë zgjidhje.

Gjatë vitit 2022 ka pasur pensionime të stafit administrativ, dorëheqje por edhe shumë mungesa për arsye shëndetësore. E njëjta situatë është edhe në Gjykatën Themelore – Dega në Suharekë.

Respektivisht, në Gjykatën Themelore në Prizren, me fillim të vitit 2023 kemi 15 (pesëmbëdhjetë) pozita të lira, kryesisht të referentëve, të cilat janë esenciale, dhe janë shumë të nevojshme dhe të domosdoshme të plotësohen me qëllim të funksionimit të punëve brenda Gjykatës, pasi që në mungesë të një numri kaq të madh të vendeve të pa plotësuara, punëtorët janë të ngarkuar me punë të tjera jashtë detyrave sipas kontratës dhe po obligohen të punojnë punë të tjera që nuk i takojnë.

Gjykata Themelore – Dega në Suharekë, gjithashtu ka mungesë të stafit administrativ, gjatë vitit 2022 janë pensionuar tre (3) Zyrtarë, ndërsa ka dhënë dorëheqje një (1) zyrtar. Ndërsa janë së paku dy zyrtar të cilët për arsye shëndetësore nuk arrijnë të punojnë me kapacitet të plota (marrim pushime mjekësore të detyrueshme apo edhe pa pagesë).

Andaj, është e domosdoshme, që menjëherë në tremujorin e I-rë të vitit, Sekretariati i KGJK-së, të aprovoj kërkesën e Gjykatës Themelore në Prizren, dhe degës së Suharekë, për plotësimin e vendeve të punës që janë të lira, me qëllim të mbarëvajtje së punës dhe efikasitetit, e sidomos të ofrimit të shërbimeve profesionalizmit ashtu që secili i punësuar të mbuloj sektorin e tij/saj.

1.7 Raporti mbi lëndët për procedurat SMIL – SQEP

Duke pasur parasysh se jemi në fazën e fundit të implementimit të sistemit SMIL të regjistrimit të lëndëve dhe projektit SQEP për evidencën penale të lëndëve gjatë vitit 2022 kemi bërë përpjekje që gjatë këtij viti të bëhet regjistrimi i të gjithë lëndëve në sistem SMIL, ndërmarrja e të gjitha veprimeve me sistem dhe që të bëhet lëvizja e lëndëve nëpërmjet sistemit dhe jo manualisht në raste të caktuara (sipas ankesës) dhe komunikimi nëpërmjet sistemit me gjykata tjera. Për realizim të këtij plani është përpiluar plani për barazim të lëndëve në sistemin SMIL dhe lëndëve të cilat i kanë gjyqtarë në punë fizikisht nëpër zyre të tyre. Plani i ka katër faza të ecurisë dhe tani jemi në fazën e fundit të barazimit. Me rëndësi të veçantë është evidentimi i lëndëve penale në Sistemin Qendror të Evidencës Penale ku është duke u bërë evidentimi i vazhdueshëm i cili do të vazhdojë edhe në vitin 2023 dhe për këtë do të angazhohet një zyrtar i posaçëm në mënyrë që mos të ketë ngecje në evidentimin e këtyre lëndëve pasi që gjër më tani këtë e kanë bërë zyrtarët sipas projektit dhe në ndërkohë do të skadojë mandati i tyre.

2. Aktivitet e Gjykatës Themelore në Prizren 2022

2.1 Ri funksionalizimi i objektit të Gjykatës për Divizionin Civil

Me të marrë mandatin si Kryetare e Gjykatës Themelore në Prizren në maj të vitit 2022, së bashku me stafin kemi filluar një angazhim të madh për riorganizimin e Gjykatës Themelore në Prizren, sidomos Arkivën e Gjykatës, dhe ri funksionalizimin e një objekti përcjellës të Gjykatës, në të cilin ka funksionuar Divizioni i Kundërvajtjes, i cili objekt është shfrytëzuar vetëm 25 % e kapacitetit të tij.

Fillimisht kemi identifikuar të gjitha problemet me Arkivën e Gjykatës, gjendjen e saj dhe kemi bërë një vlerësim të gjendjes në objektin përvjelës të Gjykatës me qëllim të organizimit dhe ndarjes së punëve.

Për rreth dy (2) muaj, në objektin aktual të Gjykatës, ka pasur një pastrim total duke filluar nga korridoret e Gjykatës ku kanë qëndruar lëndë që prisnin për tu arkivuar dhe Zyrat për Menaxhimin e lëndëve. Tashmë objekti i Gjykatës është i qasshëm për palë dhe të gjitha lëndët janë dërguar në Arkivë, e cila është ri organizuar dhe është në tërësi funksionale.

Përpos punëve të shumta që janë kryer në objektin aktual të Gjykatës, fokusi kryesor ka qenë në objektin përcjellës ku tashmë nga Janari i 2023 në atë objekt po funksionon Divizioni i Kundërvajtjes.

Për disa muaj rresht, kemi pasur edhe vizita nga KGJK, dhe Komisionet e ndryshme në veçanti nga Komisioni për Administrimin e Gjykatave, për funksionalizimin e këtij objekti, i cili që nga viti 2010 ishte shëndëruar në depo të arkivës dhe sendeve që ishin për asgjësim.

Me një angazhim të madh, kemi arritur që pas shumë intervenimeve, pastrimit, riorganizimit të korridoreve të Zyrave dhe të sallave të Gjykimit, këtë objekt ta funksionalizime dhe ta sjellim në gjendjen që është sot.

Tashmë në këtë objekt janë funksionale dy (2) salla të Gjykimit gjashtëmbëdhjetë (16) zyre për Gjyqtarë, dhe bashkëpunëtor profesional, dhe Zyrat për stafin administrativ, respektivisht, zyra e Pranimit, dhe Zyra për menaxhimin e lëndëve civile.

Funksionalizimi i këtij objekti ka qenë një ndër qëllimet dhe sfida kryesore që kam pasur për vitin 2022, pasi që është dashur angazhim i madh si Kryetare dhe angazhim i stafit administrativ. Tashmë objekti aktual i Gjykatës Themelore në Prizren dhe objekti i Divizionit Civil secili ka hapësirë adekuate të punës, dhe me ndihmën e partnerëve (USAID) të njëjti do të na mbështesim përmes projektit Drejtësia Procedurale, për shenjëzimin e objekteve për qasje sa më të lehtë të dhe mirë të qytetarëve dhe palëve që marrin shërbime në Gjykatën Themelore në Prizren.

2.2 Raporti mbi asgjësimin e lëndëve të Kundërvajtjes

Ashtu siç është lartcekur, një nga angazhimet kryesore gjatë vitit 2022 ka qenë riorganizimi dhe funksionalizimi i objektit të Gjykatës të Divizionit Kundërvajtjes, organizimi dhe evidentimi i lëndëve për asgjësim ka qenë një nga fokuset kryesore me qëllim të lirimit të hapësirës nga rreth 360 mijë lëndë të Kundërvajtjes.

Në këtë drejtim ka pasur një angazhim të madh nga stafi administrativ, dhe tashmë janë identifikuar dhe klasifikuar të gjitha lëndët që plotësojnë kushtet për asgjësim. Në baza ditore Gjykata Themelore në Prizren dhe degët Suahrekë dhe Dragash bënë regjistrimin dhe evidentimin e lëndëve për asgjësim.

Në fund të vitit 2022, Gjykata Themelore në Prizren dhe degët Suharekë & Dragash, kanë regjistruar lëndët e vitit 2015, ndërsa për vitin 2016 është në fazën përfundimtare. Pra për vitet 2015 dhe 2016 lëndët janë të evidentuara dhe të regjistruara, të gatshme për asgjësim.

2.3 Qasja në Gjykatë – Takimet me Qytetarët

Qasja e palëve dhe qytetarëve në Gjykatë, është jashtëzakonisht e rëndësishme për perceptimin e palëve për punën e Gjykatës, andaj edhe gjatë vitit 2022 jemi munduar që me ofrimin e kushteve të mira në objektet e Gjykatës, palëve t’iu ofrohet një qasje e lehtë për marrjen e shërbimeve në Gjykatë.

Si Kryetare e Gjykatës i kushtoi shumë rëndësi komunikimit me publikun dhe palët që marrin shërbime në Gjykatë, andaj një herë në muaj gjatë gjithë ditës pres në takim qytetarët dhe palët e interesuara, këtë ditë tashmë e kemi të emërtuar si “Dita e Hapur”. Shqetësimet dhe kërkesa e palëve i adresoi menjëherë tek gjyqtarët apo te stafi administrativ.

Gjithashtu Zyra për Komunikim me Publikun është e qasshme përmes e-mail adresës dhe në baza ditore pranojmë kërkesa nga palët dhe qytetarët, qofshin kërkesa për informata, apo njoftime të tjera, dhe për secilën pyetje apo kërkesë palët pranojnë përgjigje përmes e-mail adresës zyrtare të Gjykatës.

Partnerët me të cilët bashkëpunojmë, sidomos në këtë fazë USAID me projektin Drejtësia Procedurale, janë duke ofruar ndihmë dhe bashkëpunim të jashtëzakonshëm për vendosjen e shenjave identifikuese për objektet e Gjykatës, duke filluar nga shenjat në hyrje të objektit, dhe brenda objektit me qëllim të qasjes sa më të lehtë të qytetarëve.

2.4. Raporti mbi publikimin e vendimeve Gjyqësore – Komunikimi me Media dhe Publikun

Publikimi i vendimeve Gjyqësore, tashmë është obligim ligjor, andaj Gjykata Themelore në Prizren, publikon të gjitha vendimet që duhet publikuar sipas Udhëzimeve Administrative, brenda afrit ligjor.

Gjatë vitit 2022, janë publikuar gjithsej 3,014 vendimet të Gjykatës Themelore në Prizren, dhe degëve në Suharekë dhe Dragash.

Nga ky numër i përgjithshëm 176 vendime janë të Gjykatës Themelore – Dega në Dragash, 598 vendime të Gjykatës Themelore – Dega në Suharekë, kurse 2,240 të Gjykatës Themelore në Prizren.

Ndarë sipas natyrës së rasteve, janë 1,513 vendime të Departamenti të Përgjithshëm – Divizioni Penal, 1,297 vendime të Divizionit Civil, dhe 160 nga Departamenti për Krime të Rënda.

Gjatë vitit 2022 shohim rritje të publikimit të lëndëve Civile, kjo për shkak të ndryshimit të udhëzimit Administrativ dhe mundësisë për publikim të vendimeve meritore, por edhe për shkak të rritjes së efikasiteti të zgjidhjes së lëndëve në këtë Divizion,

Publikimi i vendimeve padyshim që rrit transparencën, dhe besimin e publiket për punë të hapur, dhe mundëson që palët që kanë interes (media, OJQ-të, por edhe qytetarët për qëllime studimore) që kenë qasje të lehtë në këto vendime.

Mirëpo, KGJK duhet të ketë parasysh në të ardhmen e afërt, krijimin e një sistemi apo programi i cili do të mundësonte anonimizimin dhe përpunimin e vendimeve, pasi që procesi i publikimit të vendimeve po merr kohë dhe angazhim të stafit. Rritja e numrit të vendimeve të publikuara Gjykatës i merr shumë kohë dhe angazhim, sepse në këtë proces duhet angazhuar disa persona dhe duhet punë (e cila është shumë teknike) dhe i merr disa ditë pune, shkarkimi, përpunimi dhe anonimizimi, konvertimi nga word në formatin PDF dhe pastaj vendosja në sistem për publikim përfundimtar.

Gjykata Themelore në Prizren, ka një qasje shumë interaktive në komunikim publikun dhe median.

Gjatë vitit 2022, Zyrtari për Qasje në Dokumente Publike ka përpiluar 22 vendime për qasje në dokumente, në bazë të kërkesave për qasje në dokumente (ky raport i është dërguar KGJK-së, për ta përcjellë në Agjencinë për Informim), ka pasur mbi 130 përgjigje ndaj kërkesave të Mediave për informata apo statistika për Gjykatën Themelore në Prizren. Gjithashtu përmes e-mail adresës zyrtare të Gjykatës, qytetarët dhe palët që marrin shërbime në Gjykatës marrin përgjigje dhe informacione sipas kërkesa të ndryshme.

2.5 Raporti mbi rastet disiplinore.

Gjatë vitit 2022, Gjykata Themelore në Prizren, Autoriteti Kompetent ka trajtuar dhjetë (10) raste të ankesave disiplinore.

Të gjitha rastet janë trajtuar brenda afateve ligjore, dhe vendimet e Autoriteti Kompetent sipas Udhëzimit të KGJK-së, tashmë publikohen në web faqen e Gjykatës.

Konsiderojmë që takimet që unë si Kryetare e Gjykatës zhvilloj me palët në “Ditën e Hapur”, kanë ndikuar që palët të mos paraqesin ankesa të papërmbajtshme, duke i'u referuar mënyrës së zgjidhjes së rasteve, dhe palët janë mjaftueshëm të informuar për rastet se kur mund të paraqesin ankesa për iniciimin e procedurës disiplinore, në mënyrë që të shmangen iniciimi i rasteve për procedurë disiplinore kur palët kanë ankesa për mënyrën e vendosjes.

2.6 Raporti mbi trajtimin e rasteve me interes publik

Në kuadër të trajtimit të rasteve që kanë interes publik, përfshirë rastet e natyrës së Korrupsionit Zyrtar apo lëndëve të shënjestruara për liberalizim vizash, Gjykata Themelore në Prizren ka treguar një kujdes të veçantë dhe është monitoruar në vazhdimësi trajtimi efikas i këtyre rasteve dhe në afate kohore të arsyeshme.

Në Gjykatë, ashtu siç parashihet edhe me procedura ligjore dhe rregullore, gjykimet kanë qenë të hapura, publiku dhe mediat kanë pasur qasje të lirë për përcjelljen e rasteve apo shpalljeve gjyqësore, përpos në rastet kur parashihen kufizimet ligjore.

Në këtë drejtim nuk kemi pranuar ankesa nga palët, mediumet apo OJQ-të që përcjellin punën e gjyqësorit, për kufizime në qasjen e tyre për përcjelljen e gjykimeve me interes për publikun.

Raste e shënjestruara “LV”

Në vitin 2022, Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda ka pasur në punë një (1) rast të shënjestruar, i cili tashmë është në fazën përfundimtare. Ky rast është trajtuar sipas Strategjisë për prioritetet dhe efikasitet, ashtu që janë caktuar seanca gjyqësore të një pas njëshme dhe për disa ditë me radhë, dhe nuk ka pasur anulim të pa arsyeshëm të seancave gjyqësore.

Kurse një (1) rast tjetër, është kthyer në rigjykim për një pikë të aktakuzës, dhe i është ndarë gjyqtarës në punë.

Korrupsioni Zyrtar dhe Veprat Penale Kundër Detyrës Zyrtare

Gjatë vitit 2022, Gjykata Themelore në Prizren ka kryer gjithsej 21 raste nga ky kapitull i veprave penale, dy (2) Departamenti i Përgjithshëm, dhe 19 departamenti i Krimeve të Rënda.

3. Përfundimi

Gjykata Themelore në Prizren, gjatë vitit 2022 ka arritur që me sukses, t'i adresojë disa probleme dhe sfida që e kanë përcjellë disa vite me radhë, në aspektin organizativ të punës dhe menaxhmentit të Gjykatës.

Është bërë riorganizimi i punës në administratën e Gjykatës, ashtu që janë identifikuar të gjitha burimet njerëzore. Pastaj është bërë shpërndarja e përgjegjësive për secilin punonjës brenda Gjykatës, duke marrë në konsideratë organogramin e Gjykatës, pozitat të cilat i mbajnë përgjegjësitë që kanë, pasi që është dashur mbulimi i punëve dhe aktiviteteve të tjera, në mungesë të stafit administrativ dhe mos plotësimit të vendeve të punës. Gjithashtu, për secilin Gjyqtar janë caktuar bashkëpunëtorët profesional, praktikë se cila nuk ka qenë në të kaluarën në Gjykatën Themelore në Prizren. Pas një angazhimi të madh, është funksionalizuar objekti për Divizionin Civile, me qëllim të ofrimit të kushteve dhe hapësirës adekuate për punë, por edhe hapësirave konkrete për palë dhe qytetarët.

Nëpërfundim të këtij viti mund të themi se viti 2023 do të jetë viti i sfidave në efikasitet të zgjidhjes së lëndëve dhe arritja e rezultateve më të mira në tërësi në zvogëlimin e lëndëve në punë

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prizren

Shpresa EMRA



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN